



01 Nri 309/26 Dt. 14.07.2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Administratës, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për lejimin e mjeteve financiare

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Administratës, bazuar në kërkesën e Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, për lejimin e mjeteve financiare për pagesë të faturës së papaguar të energjisë elektrike (rrymës) të krijuar (shpenzuar), në objektin i cili gjendet në Sheshin e Lidhjes Shqiptare në Prizren (barnatorja 2-barnatorja shtetërore), kështu që, në emër të pagesës së faturës përkatëse (borxhit) të Kompanisë Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESCO), përkatësisht për faturën e papaguar për njuhësorin me nr. DPZ 9002828, lejohen mjetet financiare në shumën prej 398.17 € (treqind e nëntëdhjetë e tetë euro e shtatëmbëdhjetë cent).
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i mallrave e shërbimeve dhe shpenzime komunale të Komunës së Prizrenit.
3. Obligohet Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Administratës,
 - Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Arkivës së Kryetarit.